



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:020425

Datë: 07.08.2024

Numri i dokumentit: 06029214

P.nr.52/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.L. nga Drenasi, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1667/21 e datës 01.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 17.07.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Sh.S., të dëmtuarit U.Sh., të pandehurit F.L. dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av. K. B. P. mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.L., nga i ati Isë, e ëma S..., e vajzërisë M..., i lindur më ..., në Drenas, tani me vendbanim në rr. "...", në Drenas, i pa punë, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 04.04.2024, me qëllim që vetit të i siguroj pasuri të kundërligjshme, duke mashtruar, duke paraqitur fakte të rreme, ka sjellë në lajthitje të dëmtuarin U.Sh., në atë mënyrë që në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, nga U.Sh. ka marr 130 shtylla të metalit, të cilat shërbejnë për betonimin e plloçës dhe 5 copë dërrasa, të cilat shërbejnë për skele, e pas 5-6 ditësh, po ashtu në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, nga U.Sh. ka marr edhe 35 shtylla të metalit, të gjitha sipas kompensimit të duhur për përdorim të njëjtave për 21 ditë, dhe me premtimin që të gjitha do të i kthej deri me datën 26.04.2021, që i dëmtuari ka besuar dhe të gjitha i ka dhënë, ndërsa i pandehuri F.L. për të gjitha këto i ka paguar shumën prej 120 euro dhe shtyllat dhe dërrasta nuk i ka kthyer deri më sot, duke i shkaktuar dëm në shumën prej 2,230 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 42, 43, 69, 70, dhe nenit 323 par.1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe nenit 462 të KPPK-së, shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Me te cilin dënim te pandehurit i shqiptohet gjoba ne shumen prej 300€ (treqind euro). Nëse i pandehuri nuk do apo nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë i njëjti ne vështrim te dispozitave te nenit 43 par 3 te KPRK-së, do ti zëvendësohet ne dënim burgu duke llogaritur 20€ për një ditë burgim. Dhe kumulativisht,

DËNIM ME BURG

Me te cilin te pandehurit F.L. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet ne kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1667/21 e datës 01.03.2022 kundër të pandehurit F.L. nga Drenasi, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 17.07.2024, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri F.L. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ta marrë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese, ndërsa si rrethanë rënduese të marrë shkallën e lartë të dashjes, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur po ashtu prokurori i shtetit i propozon gjykatës që të pajiset me certifikatë nga evidencat penale dhe nga ajo rezulton të mirët si rrethanë lehtësuese eventualisht rënduese.

I dëmtuari U.Sh. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë dhe kërkon nga gjykata që të detyrohet i pandehuri për kompensimin e dëmit material ashtu siç është përcaktuar në aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. K. B. P. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i sajë, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtën, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, gjykatës i ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të i ketë parasysh rrethanat lehtësuese, dhe atë pranimin e fajësisë, në të gjitha fazat e procedurës penale, gatishmërinë për të bashkëpunuar, faktin se është i martuar dhe baba i katër fëmijëve dhe gatishmërinë që të dëmtuarit të ia kompensojë dëmin e shkaktuar.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 i KPP-së, për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Provat e administruara dhe të vlerësuara

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i incidentit, i datës 09.06.2021; raporti i oficerit, i datës 26.05.2021; raporti i policit, i datës 09.06.2021; procesverbali mbi marrjen në pyetje për të dëmtuarin U.Sh., i datës 09.06.2021; dhe procesverbal mbi marrjen në pyetje për të dyshuarin F.L., i datës 03.09.2021.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 323 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mashtrimi e kryen “*kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet ose në çfarëdo mënyre tjetër mashtruese dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim, i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij/saj apo të pasurisë së personit tjetër ose rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme, për veten apo personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, gatishmërinë e të njëjtit për ta kompensuar palën e dëmtuar dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar faktin se i pandehuri ka qenë gjashtë here i dënuar me aktgjykim te formës se prerë kryesisht për vepra te ngjashme penale, po ashtu gjykata ka vlerësuar shkallen e përgjegjësisë penale te të pandehurit, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, dhe shkeljen e besimit nga ana e të pandehurit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë prej 300€ dhe burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.52/2022, datë: 07.08.2024

Zyrtarja ligjore
Arta Jusufi

GJYQTARI
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.